



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 376, datë 01.10.2020**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94 e 95 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve, etj.”

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, “2 AL”; person i tretë: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë Sokol Ngresi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese, etj.”

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë Klodiana Gjyzari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}”; Të paditur: {...}{...}; Objekti: (Sigurim padie, bllokimin e çdo veprimi për tjetërsimin e makinerive, etj.) “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse : Shoqëria {...}; Të paditur: Shoqëria {...}; Objekti: (Pavlefshmëri titulli ekzekutiv, faturë energjie elektrike) “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

## **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Korçë, si vijon:

1. Kërkesës nr. 651 prot., datë 14.09.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec; shtetas nën hetim: {...}; objekti: “Vleftësim arrest flagrante; Caktim mase sigurimi”.
2. Kërkesës nr. 647 prot., datë 14.09.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; pjesëmarrës: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; objekti: “Zëvendësim mase sigurimi”;
3. Kërkesës nr. 648 prot., datë 14.09.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; pjesëmarrës: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; objekti: “Zëvendësim mase sigurimi”;
4. Kërkesës nr. 649 prot., datë 14.09.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; shtetasit nën hetim: {...}; objekti: “Vleftësim arrest flagrante; Caktim mase sigurimi”;
5. Kërkesës nr. 650 prot., datë 14.09.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; shtetas nën hetim: {...}; objekti: “Vleftësim arrest flagrante; Caktim mase sigurimi”;
6. Kërkesës dërguar me email-in e datës 11.09.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria Korçë; shtetas nën hetim: {...}; objekti: “Masë sigurimi”;
7. Kërkesës dërguar me email-in e datës 11.09.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria Korçë; shtetas nën hetim: {...}; objekti: “Masë sigurimi”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}Objekti: “Lirim me kusht”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë Valdete Hoxha dhe Genti Shala, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; kundër: {...}; i hetuar: {...}; Objekti: “Pushimi i procedimit penal nr.63, të vitit 2019, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; Objekti: “Pushimin e procedimit penal nr.185, viti 2019.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Plagosje e rënde me dashje”.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Rishikim vendimi penal nr.113, datë 12.07.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë Shkëlqim Mustafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; Objekti: “Pushimin e procedimit penal nr.127, datë 05.02.2018, të regjistruar për veprën penale “Ekspertim i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal”.

9. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Lirim me kusht”.

10. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Ndhimë për kalim të paligjshëm kufiri”.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës Desart Avdulaj dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Sigurim padie, Rivendosje në afat”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës Izet Dushaj dhe Anita Mici, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur{...}; Objekti: “Konstatimin e pavlefshmërisë së njoftimit”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës Izet Dushaj (Relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}, etj.; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

4. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr.1301 prot., datë 23.09.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës Valbon Çekrezi dhe Desart Avdulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: I pandehur{...}; Akuza: “Nenet 130/a e 278 të Kodit Penal”.

7. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës Desart Avdulaj (Relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Objekti: “Shuarje dënimi”.

8. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës Anita Mici (Relator), Valbon Çekrezi dhe Desart Avdulaj caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria Shkodër; i dëmtuari akuzues: {...}; Objekti: “Pushimin e procedimit penal”.

## **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër Dritan Banushi caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; kallëzues: {...}; Objekti: “Pushim i procedimit penal nr.1038 të vitit 2019, procedim i regjistruar për veprën penale “Eksptertimi i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër Izet Salaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; I dënuar: {...}; Akuza: “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” dhe “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga nenet 297/2, 25 e 298/3 të Kodit Penal (Rishikim vendimi).

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër Dritan Banushi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; Kundër: {...}; Kallëzimtar: {...}; Objekti: “Pushim i procedimit penal nr.221, datë 08.04.2019, regjistruar për veprën penale “Falsifikim i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër Irena Brahimi dhe Enton Dhimitri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; persona nën hetim: {...} Dega Shqipëri, {...}sh.p.k, Shoqëria {...}sh.a, etj.; Objekti: “Pushim i çështjes penal nr.676/2018, regjistruar për veprat penale të “Eksptertimit të rremë”, “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Pengimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”, parashikuar nga nenet 309, 248 dhe 320 të Kodit Penal”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër Irena Brahimi dhe Enton Dhimitri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Kallëzues/Viktima: {...}; Objekti: “Pushimi i procedimit penal nr.378, datë 20.02.2018, të regjistruar për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**